



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 109

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE "PARTIA KOMBËTARE KONSERVATORE ALBANIA"
PËR REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE
TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 720 Prot., datë 9.2.2023, me:

Kërkues: Partia politike "Partia Kombëtare Konservatore Albania", me kryetar z. Kujtim Gjuzi.

Objekti: Regjistrimi i partisë politike "Partia Kombëtare Konservatore Albania" si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

"Partia Kombëtare Konservatore Albania", nëpërmjet kryetarit të saj z. Kujtim Gjuzi, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 8.3. 2023 Nr: 109
Ora: 11:00



"Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike "Partia Kombëtare Konservatore Albania", për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30.01.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Kombëtare Konservatore Albania” me iniciais “PKKA”, me Kryetar z. Kujtim Gjuzi, rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike, (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, me shkronja nistore “PKKA”, me adresë Rruga “Bardhok Biba”, Pll.52, ap,14, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Kujtim Gjuzi, me Rruga “Stavro Vinjau”, Pll.54, h.1, ap,14 Tiranë
- c) Financieri i partisë është z. Roxher Prifti me adresë Rruga “Dervish Hatixheja”, Pll. i ri, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Shëptim Kodhelaj, me adresë Pll, i ri mbraja Ambulancës tek 21 Dhjetori;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga partia politike “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga partia politike “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

VENDOSA:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Kombëtare Konservatore Albania”, me kryetar z. Kujtim Gjuzi, me shkronjat nistore “PKKA”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

